



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

## **Komiteti për Partneritete Publiko Private**

# **DIREKTIVA Nr. 4/2012** **për Publikime të Njoftimeve PPP**

Në pajtim me autoritetin që i është dhënë përmes Ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, Neni 17, Paragrafi 2.3, Komitetit për Partneritet Publiko Privat (KPPP) miraton këtë

## Neni 1: Përkufizimet

Termet e përdorura në këtë Direktivë, përveç nëse përcaktohen ndryshe, do ta kenë kuptimin e përcaktuar në Ligjin për Partneritet Publiko Privat (Nr. 04/L-045).

Data e publikimit të Njoftimeve - do të thotë data në të cilën njoftimi përkatës është publikuar në ueb faqen e Departamentit PPP ([www.pppkosova.org](http://www.pppkosova.org))

Data e dhënies së Kontratës – do të thotë data kur Autoriteti Kontraktues ka njoftuar të gjithë operatorët ekonomik një nga një për vlerësimin e propozimeve të tyre.

## Neni 2: Llojet e Njoftimeve

Çdo Autoritet Publik që dëshiron të implementojë një projekt PPP duhet të dorëzojë në fazat përkatëse të zhvillimit të projektit, tek Departamenti PPP versionet në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze të:

- njoftimit të kërkesës për kualifikim (shih shtojcën 1),
- njoftimit të operatorëve ekonomik të kualifikuar (shih shtojcën 2)
- njoftimit të kërkesës për propozim (shih shtojcën 3),
- njoftimit të dhënies së kontratës (shih shtojcën 4)
- njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit (shih shtojcën 5)

## Neni 3: Përmbajtja e Njoftimeve

I. Njoftimi i Kërkesës për Kualifikim duhet të përmbajë të paktën informatat në vijim:

1. Të dhëna mbi Autoritetin Kontaktues
2. Përshkrim të shkurtër të Projektit;
3. Kriteret ligjore, teknike dhe financiare për Kualifikim dhe peshën relevante të tyre
4. Informacionet Administrative (koha, vendi dhe mënyra e dorëzimit)
5. Informacionet rreth ankesave
6. Afatet e parapara kohore të procesit të prokurimit

Njoftimi i Kërkesës për Kualifikim duhet të mbetet i hapur jo më pak se njëzet (20) ditë pas datës së publikimit të tij.

II. Njoftimi i operatorëve ekonomik të kualifikuar do të publikohet nga Departamenti PPP pasi që janë informuar të gjithë operatorët ekonomik individualisht nga Autoriteti Kontraktues për suksesin e tyre në fazën e kualifikimeve.

Njoftimi për operatorët ekonomik të kualifikuar duhet të përmbajë të paktën:

1. Emrat e operatorëve ekonomik që janë kualifikuar për të marrë pjesë në fazën e dytë të prokurimit
2. Organin kompetent (duke përfshirë adresën) ku mund të ankohen operatorët ekonomik

III. Njoftimi i Kërkesës për Propozim mund të publikohet të paktën 10 ditë pas datës së publikimit të Njoftimi për operatorëve ekonomik të kualifikuar. Ky afat duhet të shtyhet në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik nr. 04/L-042, nëse është pranuar ndonjë ankesë rreth mbarëvajtjes së procesit të tenderimit përkatës në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Njoftimi për Kërkesën për Propozim duhet të përmbajë të paktën informatat në vijim:

1. Të dhëna mbi Autoritetin Kontaktues

2. Përshkrim të shkurtër të Projektit; duke përfshirë këtu kushtet e kontratës të propozuara nga Autoriteti Publik, dhe një përmbledhje të kushteve të cilat konsiderohen të pa negociueshme;
  3. Kriteret për vlerësimin e propozimeve, të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues për identifikimin e propozimeve të papërgjegjshme; peshën relative e cila i është dhënë secilit kriter të vlerësimit; dhe mënyrën në të cilën kriteret aplikohen për vlerësimin dhe refuzimin e propozimeve.
  4. Informacionet Administrative (koha, vendi dhe mënyra e dorëzimit)
  5. Informacionet rreth ankesave
  6. Afatet e parapara kohore të procesit të prokurimit
  7. Njoftimi i Kërkesës për Propozim duhet të mbetet i hapur jo më pak se dyzet (40) ditë pas datës së publikimit të tij.
- IV. Njoftimi për dhënie të Kontratës apo Anulim të aktivitetit të Prokurimit do të publikohet nga Departamenti PPP, pasi që të jenë informuar nga Autoriteti Kontraktues të gjithë operatorët ekonomik individualisht për vlerësimin e propozimeve të tyre.
- Njoftimi i dhënies së kontratës duhet të përfshijë të paktën informatat në vijim:
1. Të dhëna mbi Autoritetin Kontaktues
  2. Përshkrim të shkurtër të Projektit;
  3. Kriteret e Vlerësimit
  4. Të dhëna mbi Operatorin Ekonomik më të suksesshëm në përputhje me KPP
  5. Informacionet rreth ankesave
- V. Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit duhet të përfshijë të paktën informacionet në vijim:
1. Të dhëna mbi Autoritetin Kontaktues
  2. Përshkrim të shkurtër të Projektit;
  3. Informacionin mbi anulimin e Procedurës së Prokurimit
  4. Informacionet rreth ankesave

#### **Neni 4: Dorëzimi i Njoftimit për Publikim**

Njoftimi për Publikim do të konsiderohet i dorëzuar tek Departamenti PPP:

1. në datën e dorëzimit, në rastin e dorëzimit me dorë,
2. në datën e pranimit të njoftimit në rastin e dërgimit përmes postës së regjistruar, dhe
3. në datën që përfaqësuesit e Departamentit PPP konfirmojnë pranimin e postës elektronike ose të faksit për pranimin e njoftimit.

#### **Neni 5: Afatet për Publikimin e Njoftimeve**

Brenda dy (2) ditëve nga pranimi i njoftimeve të lartpërmendura, Departamenti PPP do të publikon të gjitha versionet e njoftimeve, në gjuhët e dorëzuara në ueb faqen [www.pppkosova.org](http://www.pppkosova.org).

Brenda tre (3) ditëve pas dorëzimit të njoftimit tek Departamenti PPP, Autoriteti Publik duhet të publikojë njoftimin në të gjitha gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës në së paku dy gazeta ditore në Kosovë.

#### **Neni 6: Hyrja në fuqi**

Kjo Direktivë do të hyjë në fuqi në ditën e miratimit të saj nga ana e KPPP dhe nënshkrimit të saj nga Kryesuesi i KPPP.



**INFORMATAT KONTAKTUESE**

Ju lutemi drejtoni kërkesat dhe pyetjet te:

Partneritetet Kosova  
Ministria e Financave  
+381 (0)38 200 34 013/202

[www.pppkosova.org](http://www.pppkosova.org)

Përgatitur me ndihmën e:



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA